


PLANI ZHVILLIMOR I SHKOLLËS (PZHSH)

2022



Kalendari i planifikimit

Grafiku më poshtë tregon se si kalendari i planifikimit për Planin e Zhvillimit të Arsimit në Komunën lidhet me kalendarin e veprimëve në nivelin e shkollave dhe atë kombëtar, dhe si të gjitha janë të lidhura me ciklin e buxhetit.



Emri i shkollës:	GJIMNAZI "EQREM ÇABEJ"
Vendi:	Rr. "Remzi Salihu" nr.61 Prishtinë
Komuna:	Prishtinë
PZSh dhe rishikimi i aprovuar nga:	Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH)
Data e aprovimit:	05.05.2022
Data e rishikimit (të ardhshëm):	05.05.2023
Nënshkruar nga Kryetari i KDSH:	Avni Rustemi

PËRMBAJTJA E PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

I. Të dhënat për shkollën	3
1.1. Përshkrimi/pasqyrimi i shkurtër i të dhënave të shkollës.....	3
1.2. Përmbledhje e të dhënave në bazë të shkollës	4
1.3. Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit).....	5
1.4. Suksesi i nxënësve sipas lëndëve – mesatarja e suksesit për vitin e fundit shkollor dhe krahasimi me vitin paraprak	6
1.5. Mungesat e nxënësve dhe braktisja	8
II. Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike	9
2.1. Vizioni dhe misioni.....	9
III. Fazat e hartimit të Planit Zhvillimor të Shkollës	10
3.1 Fazat e hartimit të planit zhvillimor të Shkollës	10
3.2. Lista e kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën për një periudhë 3 vjeçare	11
3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës.....	12
3.4. Objektivat zhvillimore të shkollës.....	17
IV. PLANI I MENAXHIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS – PLANI TRE VJEÇAR.....	18
4.1. Prioritet e përzgjedhura – arsyeshmëria	18
4.2. Pasqyra e planit tre vjeçar	19
V. PLANI VJETOR I SHKOLLËS	20
5.1. Tabela e prioriteteve	20
5.2. Monitorimit dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Shkollës.....	23
5.3. Aktivitete të tjera.....	26
SHTOJCA.....	27
1. Të dhënat bazë të SMIA-s.....	27
2. Përmbledhje e raportit të vetëvlerësimit të performancës së shkollës.....	28
3. Përmbledhje e raportit për sigurimin e cilësisë	30



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

1.1. Përshkrimi/pasqyrimi i shkurtër i të dhënave të shkollës

Veçoritë dhe profili i shkollës:

Gjimnazi “EQREM ÇABEJ” në Prishtinë e ka filluar punën në ish-lokalet e Shkollës Normale. Para se të shndërrohej në Gjimnaz i filologjisë, ishte gjimnaz matematikor, më pastaj gjimnaz kulturologjik. Nga viti 1990 e këndej, u profilizua në Gjimnaz i filologjisë, drejtimi i gjuhëve. Në vitin shkollor 2012-2013 ka ndërruar lokacionin, duke kaluar në objekt të ri në rr. “Remzi Salihu” nr.61 në Prishtinë. Gjimnazi, deri në vitin shkollor 2020-2021 veprimtarinë e vet e zhvilloi si gjimnaz i gjuhëve. Prej vitit shkollor 2021-2022 me Vendimin e MASHTI nr. 2-854 profilizohet në tipin: Gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore. Gjimnazi ka shënuar suksese të lakmueshme në të gjitha sferat e jetës. Gjimnazi “Eqrem Çabej” aktualisht ka 696 nxënës dhe 40 punëtorë, 36 mësimdhënës të rregulltë dhe 4 bashkëpunëtorë me plotësim norme nga shkollat e tjera. Ka drejtorin, sekretaren, koordinatoren e cilësisë për KB, bibliotekaren, një shtëpiak, dy roje nate dhe 9 punëtorë teknikë.

Organizimi i punës në shkollë

GJIMNAZI “EQREM ÇABEJ” KA KËTË STRUKTURË ORGANIZATIVE:

ORGANET DREJTUESE:

- Këshilli Drejtues i Shkollës
- Drejtori
- Koordinatorja e cilësisë së shkollës për KB
- Sekretarja

ORGANET PROFESIONALE:

- Këshilli i arsimtarëve
- Këshilli i klasave
- Aktivet profesionale lëndore
- Kujdestari i klasës
- Bibliotekarja

ORGANET PËRFAQËSUESE:

- Këshilli i prindërve
- Këshilli i nxënësve

STAFI I MËSIMDHËNËSVE:

- Mësimdhënësit
- Mësimdhënësit kujdestarë të klasave
- Mësimdhënësit kujdestarë të ditës

STAFI TEKNIK:

- Shtëpiaku,
- Rojet e shkollës,
- Mirëmbajtësit e higjienës



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

1.2. Përmbledhje e të dhënave bazë të shkollës

Viti shkollor: 2021-2022 ¹

Nr.	Kategoria	Përshkrimi	Koment shtesë
1.	Numri i nxënësve	Gjithsej: 696	Numri i nxënësve mund të ndryshojë çdo vit shkollor
2.	Numri i mesimdhënësve	Gjithsej: 40	
3.	Numri i mësonjësve		
4.	Numri i klasave		
5.	Anëtarë i Komunitetit të Mësuarit së bashku:	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
6.	Internet dhe wireless	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	Drejtori, sekretarja, zyra e koordinatores
7.	Dollapë për nxënës	<input type="radio"/> PO <input checked="" type="radio"/> JO	
8.	Qasje për personat me aftësi të kufizuara	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
9.	Ngrohja	Pelet	
10.	Kushtet sanitare:	Të mira	
11.	Furnizim i rregullt me ujë:	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	Me ndërprerje
12.	Tualetet (të ndara për meshkuj dhe femra)	<input checked="" type="radio"/> Brenda <input type="radio"/> Jashtë	
13.	Çanta e ndihmës së parë	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
14.	Pajisjet e zjarrit në shkollë	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
15.	EPRBM ²	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	I sapo formuar, më 21.04.2021
16.	Objektet përcjellëse	Objekti i kaldajave	
17.	Paralelet e ndara	S'ka	

¹ Kjo tabelë azhurnohet çdo vit shkollor dhe vendoset në web faqë të shkollës

² Ekipi i Parandalim dhe Reagimit ndaj Braktisjes dhe Mos regjistrimit



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

1.3. Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit)³

Klasa	Viti shkollor 2021-2022 (çdo vit) Viti paraprak shkollor			Viti shkollor i tanishëm 2020-2021 Fundi i vitit shkollorë		
	Të planif. P1	Të mbajtura M1	Ndryshimi N1=(P1-M1)	Të planif. P2	Të mbajtura M2	Ndryshimi N2=(P2-M2)
I						
II						
III						
IV						
V						
VI						
VII						
VIII						
IX						
X	8400	8371	29	8400	8372	30
XI	8400	8375	25	8400	8377	32
XII	7504	7474	30	7504	7473	29
Gjithsej	24304	24220	84	24304	24213	91

Shkalla e përmbushjes:

1. Mesatarja e orëve të mbajtura=Shuma(P1-M1):Shuma (P1) 99.65

2. Mesatarja e orëve të mbajtura=shuma(P2-M2):Shuma (P2) 99.62

³Tabela azhurnohet në fund të çdo viti shkollor



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

1.4. Suksesi i nxënësve sipas lëndëve⁴

Kosova për herë të tretë mori pjesë në testin PISA (Programi Ndërkombëtar për Vlerësim të Nxënësve) ku vlerësohen nxënësit e moshës 15-vjeçare në Matematikë, shkencë dhe lexim. Për ta përcjellur me vëmendje të shtuar paraqitjen dhe rezultatet e nxënësve në këto lëndë, nga drejtorët e shkollave kërkohet të analizojnë suksesin e arritur të nxënësve çdo vit shkollor duke e krahasuar me suksesin e viteve paraprake.

Për të pasur një pasqyrë reale të rezultateve, shkollat duhet të përpiqen ta ngrisin rezultatin nga vlerësimi i jashtëm i tyre. Nëse një gjë e tillë nuk është e mundur atëherë duhet të shfrytëzojnë rezultatet nga testi i kaluar në nivel komunal.

Shkollat, sipas nevojave dhe interesave, mund të raportojnë edhe për lëndët tjera mësimore duke shtuar rreshta të rinj në këtë tabelë.

Suksesi në Nivelin I – KSNA I (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) Klasa V

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmëvjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Mesatarja kombëtare nga suksesi i fundit (testi i kl V) ⁵	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	V						
Matematikë	V						
Shkencat e natyrës	V						

⁴Suksesi i paraqitur në këto tabela azhurnohen cdo vit shkollor dhe vendoset në web faqe të shkollës.

⁵¹ Lidhja me Divizionin për vlerësim standarde dhe monitorim (DVSM).



SHENIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.





SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Drejtori i
shkollës

I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

Suksesi në Nivelin II – KSNA II (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) klasa IX

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmëvjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Suksesi mesatar nga vlerësimi i jashtëm (semimatura)	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	IX						
Matematikë	IX						
Shkencat e natyrës	IX						

Suksesi në Nivelin III – KSNA III (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) klasa XII

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmëvjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Suksesi mesatar nga vlerësimi i jashtëm (Matura)		Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II		Afati i parë	Afati i dytë		
Gjuhë amtare	XII	4.15	4.22	4.19	95	5	245	
Matematikë	XII							
Shkencat e natyrës	XII	2.90	3.10	3	92	8	245	
Totali i përgjithshëm nga të gjitha lëndët	XII	3.30	3.44	3.37	92.33	7.66	735	



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

1.5. Mungesat e nxënësve dhe braktisja

Mungesat e nxënësve nga vitit shkollor paraprak

Klasa	Me arsye	Pa arsye	Mesatarja e mungesave për nxënës	Numri më i madh i mungesave për një nxënës
1-5				
6-9				
10-12	10785	5876	10.79	66
Total	10785	5876	10.79	66

Braktisja e nxënësve

Nxënësit që kanë lëshuar shkollën	Nxënësit kanë ndërruar shkollën, kanë konfirmuar dhe dokumentuar regjistrimin e tyre	Numri neto i nxënësve që e kanë braktisur shkollën
A	B	A-B
2	1	3



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



II. VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni dhe misioni i shkollës:

Vizioni: (deklarata e vizionit – “ëndrra realiste”)

(Deklarata e vizionit duhet të bazohet në fushat e cilësisë – përkatësisht vizioni i shkollës për arritjen/ avancimin e fushave të cilësisë gjatë një periudhe 10-vjeçare)

Brenda afatit kohor prej 10 vitesh shkolla jonë mëton të bëhet shkollë elitare gjithëpërfshirëse. Do të krijojë kushte të përshtatshme për arsimim cilësor për të gjithë. Do të sigurojë mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, pranim dhe respektim për të gjithë nxënësit e përfshirë në të, pa dallim moshe, gjinie, gjendjes së tyre sociale, fizike dhe emocionale. Është hera e parë ku shkolla realizoi Vlerësimin e Brendshëm në të gjitha Fushat e cilësisë. Rezultatet në këtë projekt gjigant janë të kënaqshme. Në të ardhmen pritet të koordinohen veprimet e përbashkëta me DKA dhe MASHTI, që të realizohet edhe Vlerësimi i Jashtëm.

Misioni: (deklarata e misionit – Si ta arrijmë këtë ëndërr realiste)

(Deklarata e misionit duhet të bazohet në fushat e cilësisë – përkatësisht misioni i shkollës për arritjen/ avancimin e fushave të cilësisë gjatë një periudhe 10 vjeçare)

Misioni ynë është të kontribuohet në zhvillimin maksimal të secilit nxënës, duke nxjerrur në pah aftësitë fizike dhe potencialin intelektual të secilit individ, të ngrisim cilësinë e mësimdhënies përmes metodologjive bashkëkohore, duke respektuar stilet e të nxënës mbështetur në aftësitë e individit, t'ua mësojmë fëmijëve respektin dhe vlerat e shoqërisë së lirë dhe demokratike, të ngrisim bashkëpunimin me të gjitha palët e interesit brenda kontekstit të shkollës.

Shkolla do të krijojë kushte për nxënësit e regjistruar, që:

- të arrijnë të dijnë,
- të veprojnë,
- të bashkëpunojnë me të tjerët,
- ta transformojnë veten dhe të tjerët
- të ndikojnë pozitivisht te të tjerët



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



SHËNIM: Kandidatët të cilët kandidohen për herë të parë për pozitën e udhëheqësit të institucionit edukativo-arsimor (iea) e plotësojnë PZSHH deri këtu. Pjesa tjetër e PZSHH plotësohet pasi kandidati të jetë zgjedhur drejtues i IEA.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

3.1. Fazat e hartimit të planit zhvillimor të Shkollës:

Në këtë pjesë (½ deri një faqe), bëhet një përshkrim i shkurtër i fazave nëpër të cilat ka kaluar procesi i hartimit të planit zhvillimor të shkollës dhe aktivitetet kryesore që janë realizuar.

- 1** Informon ekipin e shkollës mbi procesin e zhvillimit apo azhurnimit të PZSH;
- 2** Informon Bordin Drejtues të shkollës për të fillu zhvillimin apo azhurnimin e PZSH;
- 3** Mbledhja e të dhënave;
- 4** Përcaktimi i Vizionit dhe Misionit;
- 5** Analiza SWOT e bazuar në aspektet relevante të fushave të cilësisë;
- 6** Caktimi i Objektivave dhe prioritetëve, kontrollimi i koherencës mes PZHAK (Komunë) + PSAK (MASHT);
- 7** Përzgjedhja e prioritetëve;
- 8** Dakordimi mbi Planin trevjeçar: Vendimi
- 9** Nxjerrja e planit vjetor nga plani 3 vjeçar;
- 10** Marrja e vendimit: Aprovimi i PZSH nga KDSH;



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

3.2. Lista e kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën për një periudhë 3-vjeçare

Udhëzimet dhe sqarimet e detajuara për përdorim të kësaj tablele janë dhënë në Modulin III – Plani Zhvillimor i Shkollës. Nëse keni bërë vetëvlerësim ju duhet ta shfrytëzoni atë për të identifikuar aspektet relevante, shiko shtojcën 2 të bashkangjitu.

	FUSHAT E CILËSISË SË SHKOLLËS	Zgjedhë aspektet relevante të kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën
A	MENAXHIMI DHE QEVERISJA	1.1. Organet qeverisëse janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës. 1.4. Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit.
B	KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR	2.1. Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore. 2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave.
C	MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	3.1. Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore. 3.4. Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive.
D	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	4.2. Praktikantët e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve. Përfshirja në programe të ndryshme trajnimi në arritjen e rezultateve kurrikulare.
E	PERFORMANCA E NXËNËSVE	5.1. Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet. Nxënësit janë të lirë t'i paraqesin shqetësimet e tyre, propozimet për ndryshim. Janë të lirë të organizojnë aktivitete që vlerësohet të ndikojnë në përmbushjen e rezultateve të synuara kurrikulare.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

3.3. Analiza e gjendjes në fushat e cilësisë së shkollës – analiza SWOT Shto aspektet nga tabela 3.1

Udhëzimet dhe sqarimet e detajuara për përdorim të kësaj tablele janë dhënë në Modulin III – Plani Zhvillimor i Shkollës.

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
A	<p>MENAXHIMI DHE QEVERISJA</p> <p>1.1. Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës.</p> <p>1.2. Shkolla ka në fokus të orijentimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve</p>	<p>Në kuadër të kësaj fushe mund të konstatohet se: Udhëheqja gjegjësisht drejtori i shkollës bën përpjekje që të zbatojë praktika gjithëpërfshirës e në udhëheqjen dhe përparimin e shkollës.</p>	<p>Nevoja e ngutshme e intervenimeve teknike në ndërrimin e dritareve në anën perendimore dhe jugore, intervenimi në kulm dhe mveshja e tij nga ana e brendshme, klimatizimi i sallës së sporteve dhe shtrirja e rrjetit të internetit në gjithë hapësirën e shkollës, pasurimi i kabineteve dhe klasave me mjete të teknologjisë, ndikojnë shumë në ngritjen e kushteve të favorshme. Planifikimi i korrigjimit të oborrit të shkollës shton gjasat që shkolla të shndërrohet në vend më atraktiv edhe për komunitetin.</p>	<p>Bashkërendimi i veprimeve të koordinuara nga institucionet tona arsimore dhe qeverisëse, siç janë DKA, MASHTI, do të ndikojë në përmirësimin e kushteve në shkollën tonë dhe në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie.</p>	<p>Mungesa e investimeve në shkollë, për drejtorin, koordinatoren e cilësisë së shkollës dhe mësimdhënësit, do ta vështirësojë punën në funksionimin e punës normal dhe më efikase, nëse nuk bëhet me kohë një investim përmbajtësor, që do të ndikojë pozitivisht në rolin funksional të shkollës.</p>



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



KN



KP



KDSH

<p>1.3. Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimin të integruar.</p> <p>1.4. Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit.</p>				
---	--	--	--	--

Plotësoni fushat në tabelë dhe rrumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
B	<p>KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR</p> <p>2.1. Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore për të gjithë.</p> <p>2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave.</p> <p>2.3. Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës.</p>	<p>Në këtë fushë shkolla, në krahasim me vitin e shkuar, ka përmirësim thelbësor në infrastrukturë. Janë zgjeruar hapësirat që nuk ishin funksionale për punë deri më tani. Zhvendosja e kabinetit të TIK-ut nga kati i dytë në të parin, caktimi i zyrës së koordinatores së cilësisë të parin, caktimi i zyrës së koordinatores së cilësisë</p> <p>Është bërë zhvendosja e bibliotekës së shkollës dhe lirimi i hapësirës paraprake e cila shfrytëzohet sallë testesh. Është funksionalizuar kabineti i gjuhëve, Biologjisë, Fizikës, Artit muzikor.</p>	<p>Disa dritare jofunksionale në shkollë ndikojnë dukshëm në humbjen e temperaturës së ngrohtë gjatë stinës së dimrit. Edhe dyert veriore të shkollës është e nevojshme të ndërrohen sepse ndikojnë shumë në ftohjen e ambientit të shkollës.</p> <p>Hapësira e madhe dhe e panevojshme e betonizuar e oborrit të shkollës duhet zvogëluar. Mungesa e rrjetit të internetit nëpër klasë dhe e paisjeve të teknilogjisë (projektorëve statikë, lap-topëve për secilën klasë)</p>	<p>Mekanizmat udhëheqëse të shkollës, në bashkëpunim me DKA-në dhe MASHTI të mobilizohen urgjentisht në përmbushjen e prioritetëve të shkollës që janë të ngutshme. Kërkesat për përmirësimin e kushteve në shkollë duhet të</p> <p>mos ndalen deri sa të realizohen, në DKA dhe MASHTI.</p>	<p>Vlerësohet lart se nëse nuk intervenohet në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të shkollës, mund të vijë deri te rrezikimi i drejtpërdrejtë i shëndetit të nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollës; do të ndikojë në shumë në demotivim për mësimdhënie dhe nxënie efikase dhe më cilësore. Përgjithësisht, vlerësohet se do të zbehet puna e bërë në shkollë, me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të larta në mësim.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rrumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukceset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
C	<p>MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA</p> <p>3.1. Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore.</p> <p>3.2. Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit</p> <p>3.3. Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar</p> <p>3.4. Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive</p>	<p>Në këtë fushë në kuadër të shkollës në krahasim me vitin paraprak, ka një ngritje pozitive në pjesën e mësimdhënies dhe të nxënësve në përgjithësi, ku vërehet zbatim i metodologjive të reja të shumica e mësimdhënësve të trajnuar. Përdorimi i platformave të ndryshme në realizimin e mësimin në distancë, të platformës e-Shkollori.</p>	<p>Te një numër i vogël i mësimdhënësve të cilët kanë vështirësi në përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, ka vështirësi në zbatimin e metodologjive të mësimdhënies dhe nxënësve më efikase, në zhvillimin e mësimin në distancë.</p>	<p>Mësimdhënësit të ndjekin programe të ndryshme trajnimi, që do të ndikojnë në mënyrë të theksuar në ofrimin e përvojave sa më efikase në mësimdhënie dhe arritjen e rezultateve më të larta në mësimdhënie dhe mësimnxënie..</p>	<p>Mësimdhënësit, nëse nuk i vijojnë trajnimet dhe zbatimin e përvojave të fituara, në praktikë, mund të mos i arrijnë rezultatet e synuara në formë të kënaqshme me nxënësit e tyre.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



3.3. Analiza e gjendjes në fushat e cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
D	<p>ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE</p> <p>4.2. Praktikrat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve.</p> <p>4.3. Praktikrat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar.</p> <p>4.4. Shkolla përdorë në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM.</p> <p>4.5. Shkolla mbikqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në shkollë, kadri arsimor është 100% i kualifikuar. Ngritja profesionale e tyre</p> <p>akoma është e nevojshme në fitimin e përvojave të reja profesionale. 90% e tyre kanë ndjekur trajnimet për kurrikulën e re. Ka programe tjera shumë të dobishme që ofrohen për ngritjen profesionale të mësimdhënësve. Mbështetja nga DKA, mundësom organizimin e trajnimeve me bazë në shkollë.</p>	<p>Një pjesë e vogël e mësimdhënësve nuk kanë ndjekur trajnime në ngritjen e tyre profesionale për arsye të mungesës së organizimeve trajnuese për ta...</p>	<p>Nevojiten përfshirje e vazhdueshme në programe të ndryshme trajnimi.</p>	<p>Nëse nuk bëhet diç në shtimin e kapaciteteve trajnuese të mësimdhënësve, do të reflektojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në arritjen e rezultateve në mësimdhënie dhe në arritjen e rezultateve të kompetencave të synuara nga nxënësit.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



3.3. Analiza e gjendjes në fushat e cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukceset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
E	<p>PERFORMANCA E NXËNËSVE</p> <p>5.1. Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet.</p> <p>5.2. Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmëritë e vendosura me KB.</p> <p>5.3. Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmëritë e vendosura me KB.</p> <p>5.4. Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete jashtëkurrikulare.</p>	<p>92% e nxënësve të shkollës sonë arrijnë të kalojnë Testin e Maturës Shtetërore. Mbështet realizimi i mësimin në projekteve, meqë shumica e mësimdhënësve kanë të përfunduar MBP.</p>	<p>8% e nxënësve kanë vështirësi në performancën e tyre.</p>	<p>Organizimi më efikas i punës së mësimdhënies dhe mësimnxënies, paisja e shkollës me mjete konkretizimi, do të kontribuonte pozitivisht në ngritjen e performancës më të lartë tek nxënësit.</p>	<p>Mund të jetë rrezik demotivimi i nxënësve në pjesëmarrje aktive në aktivitete të shumta shkollore dhe në zotërimin e rezultateve të përcaktuara të kompetencave në fushat kurrikulare.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rrumbullako të paktën tri prioritetet kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

3.4. Objektivat zhvillimore të shkollës

Objektivat zhvillimore të shkollës prezantohen dhe përshkruhen. Këto objektiva janë specifike për shkollën por gjithëashtu në mënyrë të qartë të lidhura dhe në korrelacion të drejtpërdrejtë me objektivat Zhvillimore Komunale të Arsimit të theksuara në PZHKA të komunës përkatëse.

Interesi kombëtar – Objektiva e marrë nga MASHTI	
1	Ngritja e cilësisë nëpër shkolla Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve
2	Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Interesi Komunal – Objektiva e marrë nga PZHKA	
1	Ngritja e cilësisë në shkollë Mjedis i sigurtë dhe miqësor në shkollë
	Zbatimi në tërësi i kurrikulës Përdorimi i teknologjisë në përmbushjen sa më të lehtë të rezultateve kurrikulare

Interesi i shkollës – Objektiva e marrë nga Shkolla	
1	Zhvillimi profesional, gjithëpërfshirja dhe llogaridhënia
2	Përdorimi i TIK-ut në konkretizimin e temave mësimore
3	Bashkëpunimi me prindër dhe komunitetin, me OJQ-të dhe institucionet e larta të arsimit.
Bazuar në fushat e rrumbullakuara nën 3.2 por të transferuara në Objektiva Realiste	



SHËNIM: Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



IV. PLANI I MENAXHIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS – PLANI TREVJEÇAR

4.1. Prioritet e përzgjedhura – arsyeshmëria

(**kriteret:** rëndësia, mundësia për të përmirësuar cilësinë e punës në shkollë, urgjenca, kapacitetet për implementim dhe qëndrueshmëria) përfshirë planin e veprimit nga komunitetet e të mësuarit së bashku (PV i KMS)

Nr.	Fushat e Cilësisë (A-E)	Renditja e të gjitha objektivave ⁶	Arsyeshmëria për prioritetet e përzgjedhura bazuar në SWOT, PSAK, PZHKA dhe PV i KMS
1	A MENAXHIMI DHE QEVERISJA	-Të bëhet angazhimi i psikologut të shkollës Të funksionalizohen dhe furnizohen me inventar dhe kompjuter, skaner, printer të zyrave të drejtorit, kordinatorit. Vlerësimi i performancës së brendshme të shkollës (në secilin vit).	Në bazë të gjetjeve me analizën SWOT vërehet që është e domosdoshme kompletimi i stafit të shkollës sepse shkolla jonë me afër 696 nxënës. Vlerësohet angazhimi i psikologut, furnizimi i rrjetit të internetit në tërë hapësirën e shkollës, furnizimin me mjete teknologjike. Vlerësimi i performancës të bazuar në kriteret.
